



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 35, QARKU
TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORAGNET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 16.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 35, Qarku Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", neni 93 dhe 94 pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1568 prot., datë 04.04.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Tiranë, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Tiranë që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për tetëmbëdhjetë (18) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Tiranë, me shkresën nr. 2588 prot, datë 30.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për seicilën nga VNV-të e këtij Qarku.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr. 35 (Njësia Bashkiake Nr. 5), Qarku Tiranë, është:

1. Shkolla 9 vjeçare "Vasil Shanto", palestra me sipërfaqe 522 m²; Njësia Bashkiake Nr. 5, Bashkia Tiranë.



Nr. 408 i Vendimit Data 16.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.35, Qarku Tiranë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Shkolla 9 vjeçare "Vasil Shanto"(Palestra), ka qenë Vend Numërimi të Votave në zgjedhjet e mëparshme, ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

ZAZ Nr. 35 ka në juridiksionin e saj 94 qendra votimi, dhe në bazë të përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 09.04.2015, ambienti i VNV-së duhet të ketë një sipërfaqe prej jo më pak se 300 m².

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 35, në Shkollës 9- vjeçare "Vasil Shanto", palestra me sipërfaqe 522 m2, Njësia Bashkiake Nr. 5, Bashkia Tiranë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 408 i Vendimit Data 16.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.35, Qarku Tiranë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019